

VENDIM
Nr.513, datë 30.7.2004

**PËR KLASIFIKIMIN E VEPRIMTARISË DHE PËR DOKUMENTACIONIN E
PROCEDURËN PËR DHËNIEN E LEJES NGA INSPEKTORI I PUNËS, PARA VËNIES NË
PUNË TË NDËRMARRJES**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 1 të nenit 41 të ligjit nr.7961, datë 12.9.1996 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 139 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Punës dhe të Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Punëdhënësi, i cili në veprimtarinë e vet kryen punë të klasifikuara, të vështira ose të rrezikshme për jetën dhe shëndetin e njeriut, në përputhje me vendimin nr.207, datë 9.5.2002 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e punëve të vështira ose të rrezikshme”, para vënies në punë të ndërmarrjes a të një pjese të saj, para hapjes së mjedisit të punës, si dhe para çdo ndryshimi të rëndësishëm në mënyrën e punës, për prodhimet e përdorura, makineritë dhe pajisjet, duhet të marrë leje nga inspektori i punës.

2. Punëdhënësi për marrjen e lejes paraqet pranë inspektoratit të punës së rajonit, në juridiksionin e të cilit ndodhet ndërmarrja, kërkesën me shkrim dhe dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Planin, projektin e vendeve të punës për ajrimin, ndriçimin, zhurmat dhe dridhjet, ndotjen, substancat e rrezikshme;

b) Listën e lëndëve të rrezikshme, që do të përdorë në ndërmarrje;

c) Miratimin e planimetrisë së ndërmarrjes nga Inspektorati Elektrik;

ç) Sipërfaqen dhe vëllimin e vendit të punës;

d) Instalimin e makinerive dhe të pajisjeve.

3. Inspektori i punës verifikon dokumentacionin e paraqitur nga punëdhënësi dhe e njofton atë brenda 10 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës me shkrim, nëse ky dokumentacion është i rregullt apo ka nevojë për plotësime të mëtejshme.

4. Nëse dokumentacioni, që i bashkëlidhet kërkesës me shkrim, ka mangësi, punëdhënësi duhet ta plotësojë atë brenda 5 ditëve nga data e njoftimit.

5. Inspektori i punës, brenda 10 ditëve nga data e plotësimit të dokumentacionit të parashikuar në pikën 2 të këtij vendimi, verifikon vendet e punës në ndërmarrje për:

a) ajrimin dhe ventilimin, në përputhje me vëllimin, mjedisin dhe numrin e punonjësve;

b) daljet nga ndërtesa në rast zjarri;

c) masat mbrojtëse, kundër zjarrit;

ç) masat mbrojtëse kolektive dhe individuale;

d) garderobën dhe instalimet sanitare;

dh) ndihmën e shpejtë;

e) mjediset për ngrënie.

6. Inspektori i punës, brenda 5 ditëve nga përfundimi i verifikimit të vendeve të punës, vendos dhënien ose refuzimin e lejes.

7. Ankimi ndaj vendimit të inspektorit të punës për refuzimin e dhënies së lejes, mund të bëhet tek inspektori i përgjithshëm, i cili shprehet me vendim, brenda 10 ditëve nga data e paraqitjes së ankesës.

8. Ankimi ndaj vendimit të inspektorit të përgjithshëm mund të bëhet te Ministri i Punës dhe i Çështjeve Sociale, i cili shprehet me vendim, brenda 20 ditëve nga data e paraqitjes së ankesës.

9. Ankimi ndaj vendimit të Ministrit të Punës dhe të Çështjeve Sociale mund të bëhet në gjykatë, brenda 30 ditëve nga data e njoftimit.

10. Ngarkohet Ministri i Punës dhe i Çështjeve Sociale për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano